



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
NJËSIA E PROKURIMIT

Klos, më 14/09/2022

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sistemi i kanaleve të ujërave të zeza KUZ dhe ujërave të bardha KUB, në rrugët Riza Beg Çela dhe Murat Basha, Bashkia Klos”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Ndërtim kanalesh (45247110-4).

VLERA E FONDIT LIMIT: 21,027,491 (Njëzet e një milion e njëzet e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa t.v.sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Klos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertes sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopjet e çertifikuara të bilanceve për vitet **2019, 2020 dhe 2021** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Keto bilance të jone të konfirmuara nga ky autoritet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021**, ku vlera e xhiros mesatare duhet të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2021**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shenim: Per kete pike 2.2.3 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes se kontrates, te gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, neni 26 e LPP, si dhe neni 26 pika 1, neni 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti Teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001 : 2015** ose ekuivalente (e vlefshme).
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001 : 2015** ose ekuivalente (e vlefshme).
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **OHSAS 18001 : 2007 ose ISO 45001 : 2018** ose ekuivalente (e vlefshme).
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të integruar **PAS 99 : 2012** ose ekuivalente (e vlefshme).
5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të sigurisë së informacionit **ISO 27001 : 2013** ose ekuivalente (e vlefshme).
6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të përgjegjësive sociale **SA 8000 - 2014** ose ekuivalente (e vlefshme).
7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të energjisë **ISO 50001-2018** ose ekuivalente (e vlefshme).
8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e menaxhimit të punimeve të germimit dhe punimeve nentoksore **BS EN 13331-1:2002** ose ekuivalente (e vlefshme).

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punëve që do të marrë për të realizuar sipas aktmarrëveshjes.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021). Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

1.1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Certifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalish sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën Profesionale të Shoqërisë, për realizimin e punimeve, objekt i Lotit, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit MPPT/MTI në kategoritë:

- NP - 1 A Punime germimi ne toke
- NP - 4 A Rrugë, autostrada , mbikalime , hekurudha ,tranvai , metro , pista aeroportuale
- NP - 5 A Punime nentokesore, ura e vepra arti
- NP - 7 B Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
- NP - 12 A Punime te inxhinierise se mjedisit
- NS – 1 A Punime per prishjen e ndertimeve
- NS - 18 A Punime topogjeodezike
- NS - 19 A Sisteme kundra zhurmes per infrastrukturen

Ne rast të bashkimit të operatoreve ekonomikë, Licencat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik qe ka marre përsipër punimet për te cilat kërkohet licenca profesionale.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e se miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të

zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet te sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 45 punonjës në fushën e ndërtimit të siguruar për periudhën Qershor 2022 – Gusht 2022 . Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar te punonjësve për periudhën e kërkuar.
- Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar.

Argumentim: *Ky kriter eshte vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale te lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Janar 2022 – Mars 2022, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

4. Operatori ekonomik duhet te kenë të punësuar si staf teknik të përfshirë në licensën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, për të cilët duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2022 – Gusht 2022, inxhinierët si më poshtë:

- Min. 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- Min. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- Min. 1 (një) Inxhinier Topograf

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, elektrik ,topograf dhe gjeolog është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Gjithashtu në lidhje me inxhinierin e mjedisit është vendosur bazuar në ligjin Nr. 10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar, neni 20, pika 4, ku parashikohet: “Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë.”

5. Në zbatim të VKM-së Nr. 108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.a dhe 1.b:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” (të paraqitet certifikata e trajnimit), i cili duhet të figurojë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën Qershor 2022 – Gusht 2022 ose duhet të paraqesë një kontratë me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes, e cila duhet të ketë kohëzgjatje për të mbuluar të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimeve që janë objekt i këtij prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e punonjësve të specializuar të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2022 – Gusht 2022 , me profesionet si mëposhtë:

- Teknik ndërtimi min. 1 (një)
- Hidraulik montues te tubave HDPE min. 2 (dy)
- Karpentiere min 2 (dy)
- Mjek ndermarrje min. 1 (nje)
- Ekspert per ndihmen e pare dhe mbrojtjen ndaj emergjencave min. 1 (nje)

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				
2				
.....				

Për punonjesit e mësipërm të paraqiten kontratat e punes te vlefshme si dhe certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat/diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”

1. Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar minimum **3 (tre) manovratorë**. Për Manovratorët të paraqitet kontrata e punës, deshmitë e drejtimit nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme.
2. Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij **min. 3 (tre)** punonjës shoferë. Detyrimisht të paraqitet kontratë pune e vlefshme si dhe dëshmi drejtimi nga DPSHTRR.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Stafin e punonjësve te specializuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar. Punëtoret e specializuar (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtores) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë punetore te specializuar sipas pikës 6,7,8 i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit. Kohështrirje per periudhen Mars 2022 – Maj 2022 , per specialistet dhe punetoret e thjeshte te ndertimit tregon besueshmëri për autoritetin kontraktor dhe aftësinë e operatorit ekonomik per ofrimin ne menyre te qëndrueshme te specialisteve dhe punonjesve te domosdoshëm per kryerjen e punimeve sipas parashikimeve te preventivit.

Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Neni 39, pika 6, germa c) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo kerkese eshte vendosur bazuar ne makinerite e kerkuara per te cilat nevojiten manovratore per mjetet e renda te pajisur me deshmine profesionale si dhe shofera per kamionet, te kerkuara ne listen e mjeteve.

7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme të cilat duhet të jenë në pronësi ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet min 25 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet 12 -17 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
3	Kamion vetshkarkues me kapacitet 3.5-5 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
4	Kamioncina me kapacitet 1.5-2 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
5	Rimoriator	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
6	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
7	Autopompe betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
8	Betoniere	Ne pronesi ose me qera	Cope	3
9	Depozita uji	Ne pronesi ose me qera	Cope	3
10	Gjenerator	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
11	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
12	Rrul mbi 12 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
13	Bobcat	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
14	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
15	Eskavator me zinxhire	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
16	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
17	Kontejner i levizshem	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
18	Manometer	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
19	Tokmak	Ne pronesi ose me qera	Cope	1

- Për mjetet në pronësi, **nëse parashikohet ne ligj**, duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme),
- Për mjetet e deklaruar me qera, **nëse parashikohet ne ligj**, duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi (nëse parashikohet ne ligj); ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit për të tretë (e vlefshme),
- Për pajisjet duhet te paraqitet kontratë noteriale e blerjes/faturë tatimore/dokument zhdoganimi të mjetit/pajisjes. Për pajisjet me qera te paraqitet kontrata e qerasë shoqëruar me akt pronësie/kontrata shit-blerje/kontrata dhurimi/faturë tatimore shitje/deklaratë zhdoganimi.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga projektuesi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapesirat fizike rreth objektit mundesive te manovrimit me mjete te renda.

Dokumentacioni shoqëruet i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensë **III.2.B** per “**Grumbullim, dhe transportim i mbetjeve inerte dhe urbane jo te rrezikshme**” dhe te jete i paisur me license III.1.A Tipi C “Leje e thjeshte mjedisore”

Argumentimi: Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes se mjedisit në punë dhe dokumentat përkatëse të operatoreve i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, relacioni teknik, projekti dhe preventivi i zbatimit te punimeve jane hartuar nga projektuesi, bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Shënim: Në specifikimet teknike, në rastin e përmendjes të një marke prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara apo një markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjala “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____
2. _____
3. _____